



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.5 prot.

Himarë, më 28.04. 2026

ZBARDHJE E PROTOKOLLIT NGA ORGJINALI I MBLEDHJES TË RADHES SË KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË.

Sot më datë 28.04.2026 zhvillohet mbledhja e radhës kërkuar nga Kryetari i Këshillit Bashkiak. Hapet mbledhja në orën 11:00 salla “Neço Muko”.

Të ftuar kryetari Bashkisë, nënkryetarët e Bashkisë, drejtoritë, administratorët e njësive, kryetarët e fshatrave.

Marrin pjesë këshilltarët :

Dhimitër Kapaj, Elisabeta Lamaj, Aleks Llazari , Mirka Gjiçali, Gjergji Iliadhi, Milto Nika, Afrovita Dhimojani, Qirjako Mërkuri, Artan Bala, Theodhori Foto, Nikolin Laska, Silvana Burbo, Nertila Husi.

Plotësohet kuorumi me 13 anëtarë të Këshillit Bashkiak.

Hap mbledhjen kryetari i këshillit, dhe hedhim në votim rendin e ditës dhe bien dakord të gjithë këshilltarët prezent.

Pika e pare: Diskutohet për projektvendimin e qendrës “Copëzat”, relaton këshilltarja Silvana Burbo dhe si anëtare e komisionit të bujqësisë. Sqaron kryetari i bashkisë për këtë projektvendim. Këshilltarja Afrovita Dhimojani pyet kryetarin e bashkisë nëse ky projektvendim ka lidhje me projektvendimin në mbledhjen e shkurtit për qendrën komunitare, stacion policie dhe zjarrfikëse , po në fshatin Palasë.

Sqaron përsëri kryetari i bashkisë. Hidhet për votim ky projektvendim, 11 pro, 2 kundër 0 abstenim.

Pika e dytë: Plan i punës për sezonin turistik.

Ky projektvendim sqarohet nga drejtoria juridike dhe kryetari i bashkisë. Kalon për votim 13 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika e tretë: Restaurimi i banesave të amorizuara për vitin 2026.

Sqaron kryetari i këshillit , sepse kryesia ka vendos që të ngrihet një komision për evidentimin e këtyre banesave dhe nëse është nevoja të ketë shtesë dhe për banesat të tjera për restaurim.

Ky komision i dakordësuar nga anëtarët e këshillit do të sjellë raportin brenda muajit maj.

Kalon për votim paraprak ky projektvendim, 13 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika e katërt: Pika për depozitimin e mbetjeve të ngurta në zonën e Palasës.

Ngre disa problematika këshilltari Milto Nika, sqaron drejtoria juridike. Pyet kryetari i këshillit se si tarifohen këto subjekte që depozitojnë mbetje. Sqaron drejtoria juridike. Kalon për votim 12 pro, 0 kundër, 1 abstenim.

Këshilli kërkon 10 minuta pushim, ora 12:30.

Fillon përsëri mbledhja ora 12:45

Pika e pestë: Himara Invest.

Sqaron drejtoria juridike ketë projektvendim. Këshilltarja Afrovita Dhimojani kërkon një sqarim përmbledhës për Himara Invest. Sqaron kryetari i bashkisë. Kalon për votim 11 pro, 2 kundër, 0 abstenim.

Pika e gjashtë: Ndihma ekonomike.

Kalon për votim 13 pro 0 kundër 0 abstenim.

Mbyllet mbledhja për e radhës për muajin prill në sallën “Neço Muko”, ora 13:15.

Sekretari : Zaho Dedi